

EFTALI QIRJAQI



Adresa: Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti",

Shkodër, Albania

Tel +355 2 22 417 46

Cel. 06902079434, Cel 0692069434

e-mail: eliqirjaqi@yahoo.com

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

**Për Auditimin e Fondeve të Përfituara dhe të Shpenzuara
Për vitin kalendarik 2014**

PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Shkodër 26 Tetor 2015

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

DREJTUAR KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"

Pallati i Kongreseve, Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.7706, dt.28.09.2015, kam audituar pasqyrat financiare të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut që përfshijnë pasqyrën e bilancit kontabël me 31 dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e fluksit monetar, pasqyrën e ndryshimeve në pasurinë neto për periudhën 01 Janar 2014 deri në 31 Dhjetor 2014, dhe përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme, se pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshire këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura nga subjekti zgjedhor, arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi si dhe vlerësimet e paraqitjes së përgjithshme të deklarimeve financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

OPINION

Sipas opinionit Tim, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të gjendjes financiare të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut me datë 31 Dhjetor 2014, të flukseve të parasë dhe lëvizjes në pasurinë neto, mbyllur më këtë datë dhe të fondeve të fituara dhe shpenzimeve të kryera, me përjashtim të parregullsive pjesore në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përshtatje me ligjin 9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Eftali QIRJAQI

Shkodër, me 26/10/2015



PASQYRAT FINANCIARE

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

PASQYRA E BILANCIT KONTABËL

Periudha 31/12/2014

Monedha në Lekë

Pershkrimi	Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2014	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2013
AKTIVET			
Aktive Afatshkurtera			
<i>Aktive monetare</i>		1,695,025	1,923,558
Mjete monetare ne arke		379,035	257,963
Mjete monetare ne banke		1,315,990	1,665,595
<i>Inventaret</i>		0	0
<i>Aktive to tjera financiare afatshkurtra</i>		0	0
Kerkesa te arketueshme		0	0
Debitore te tjere		0	0
Totali i Aktiveve Afatshkurtera (I)		1,695,025	1,923,558
Aktive Afatgjata			
<i>Aktive afatgjata materiale</i>		95,000	95,000
Toka			
Ndertesa			
Makineri e paisje			
Te tjera		95,000	95,000
<i>Aktivet afatgjata jomateriale</i>		-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		95,000	95,000
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		1,790,025	2,018,558



Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

PASQYRA E BILANCIT KONTABËL

Periudha 31/12/2014

Monedha në Lekë

Pershkrimi	Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2014	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2013
DETYRIMET			
Detyrime Afatshkurtera			
Detyrime ndaj Furnitoreve			
Detyrime ndaj punonjesve			
Detyrime tatimore			
Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		0	0
Detyrime Afatgjata			
Huamarrje te tjera afatgjata			
Grante dhe te ardhura te shtyra			
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		0	0
Totali i Detyrimeve (I + II)		0	0
PASURIA NETO			
Pasuria neto ne fillim to periudhes		2,018,558	5,869,419
Rezerva e Drejtimit			
Teprica e burimeve te vitit financiar		-228,534	-3,850,871
Totali i Pasurise neto (III)		1,790,025	2,018,558
TOTALI I DETYRIMEVE DHE PASURISE NETO (I,II,III)		1,790,025	2,018,558



Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Periudha 01/01/2014 - 31/12/2014

Monedha në Lekë

Pershkrimi	Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2014	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2013
Burimet (te ardhurat) nga:			
Kuota e antarsisë		0	0
Fonde publike nga shteti		4,794,329	8,073,595
Dhurime nga persona fizik dhe persona juridik		0	307,200
Burime të tjera		0	0
Totali i burimeve		4,794,329	8,380,795
Te ardhura te tjera (kompensim per en.elektrike)		577,000	0
Shpenzime (perdorime)			
Perdorimet per veprimtarine kryesore			
Paga e Shpërblime për fushatën zgjedhore		1,972,220	4,169,861
Qera salle		138,320	112,360
Flamuj, bluza, postera, fletëpalosje, reklamë, banderola e materiale të tjera			3,457,778
Shpenzime telefonike dhe internet		288,232	645,117
Shpenzime energji ujë		350,866	452,273
Shpenzime kancelari			144,410
Shpenzime udhëtime dieta		378,200	1,379,180
Sherbime riparime pj.këmbimi karburant			1,484,741
Taksa vendore		28,936	67,560
Komisione bankare		9,186	7,680
Të tjera		2,433,903	310,706
Totali i shpenzimeve		5,599,863	12,231,666
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore		-228,534	-3,850,871
Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimi		0	0
Totali i to ardhurave dhe shpenzimeve financiare		0	0
Teprica e burimeve neto e vitit financiar		-228,534	-3,850,871



Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

PASQYRA E NDRYSHIMIT TË FLUKSIT MONETAR

Periudha 01/01/2014 - 31/12/2014

Monedha në Lekë

Pershkrimi	Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2014	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2013
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit			
Teprica e burimeve		-228,534	-3,850,871
Rregullime per:			
Amortizimin		0	0
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave to arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave to arketueshme to tjera		0	0
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per t'u paguar nga aktiviteti		0	0
Mjete monetare to perfituara nga aktivitetet		-228,534	-3,850,871
Interesi i paguar		-	-
Tatim mbi fitimin i paguar		-	-
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytezimit		-228,534	-3,850,871
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		0	-95,000
Te ardhura nga shitja e pajisjeve			
Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet investuese		0	-95,000
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare			
Hyrje nga huamarrje afatgjata		0	0
Pagesat e detyrimeve te furnizimit			
Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet financiare		0	0
Rritja/renia neto e mjeteve monetare		-228,534	-3,945,871
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel		1,923,558	5,869,419
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel		1,695,025	1,923,558



Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

PASQYRA E NDRYSHIMIT NË PASURINË NETO

Periudha 01/01/2014 - 31/12/2014

Monedha në Lekë

Pershkrimi	Shenim	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2014	Ushtrimi i mbyllur 31/12/2013
Pozicioni i mepareshem		0	0
Teprica neto per periudhen kontabel		2,018,558	5,869,419
Rezerva e Drejtimit		0	0
Totali		2,018,558	5,869,419
Teprica e burimeve per periudhen kontabel		-228,534	-3,850,871
Kalimi i teprices se burimeve te vitit ne pasurine neto		-228,534	-3,850,871
Pozicioni me 31.12.		1,790,025	-1,832,313

SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE**I. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

I.1 Baza ligjore për kryerjen e këtij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë".
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,
- Cdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

I.2 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar në bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr.6/1 date 24/02/1992. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 "Për Partitë Politike", të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimpruese", të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese", nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut eshte pajisur me NIPT K61510015P.

Qëllimi: Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut mbron interesat politike, ekonomike, social kulturore të shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare. PBDNJ kontribuon për paqen dhe qytetarinë në luftë kundër diskriminimit të të gjitha llojeve: racor, fetar, kulturor, seksual etj. PBDNJ lufton për të krijuar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. PBDNJ synon rritjen e nivelit të jetesës përmes luftës kundër varfërisë, forcimin e familjes dhe unitetit shoqëror përmes reformave ekonomike, shoqërore, edukimit dhe kulturës, konkurrencës dhe një adresimi publik dhe efikas.

Selia e partisë është në Blv. Bajram Curri, 32, kati 1, Tiranë

Organet drejtuese në udhëheqjen qendrore janë:



- Kongresi i anëtarësisë së partisë
- Asambleja kombëtare e partisë
- Komiteti drejtues kombëtar
- Bordi ekzekutiv kombëtar
- Kryetari i partisë
- Sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e partisë
- Komisioni i mbrojtjes statutore

Kryetar i partisë është zgjedhur z.Vangjel Dule.

Të ardhurat Financiare të Partisë sipas statutit përfitohen nga :

- Të ardhurat nga kuotizacionet
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- Ndhimat dhe dhuratat e anëtarëve e përkrahësve të PBDNJ-së
- Ndhimat dhe dhuratat e organizatave partnere
- Çdo e ardhur që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike

II. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

II.1 Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

- a) Pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë".
Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Lekë.
- b) Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve.
Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë në lekë. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- c) Të Ardhurat
Të ardhurat regjistrohen sipas masës së përfitimit të tyre nga fondet publike ose jopublike.

II.2 Organizimi I Kontabilitetit

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare". Partia ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontabiliteti mbahet në excel.



III. ANALIZË E PASQYRËS SË FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZIMEVE TË KRYERA

III.1 FONDET E PËRFITUARA GJATË VITIT KALENDARIK 2014

Përshkrimi sipas natyrës		Vlera
Nr.	Natyra e të ardhurave	
1	Fondet e përfituara	
1.1	Nga fondet publike	4,794,329
1.1.1	Fondi për vitin 2014	4,794,329
1.2	Donacionet e përfituara në vlerë monetare	0
1.2.1	Donacionet nga persona fizikë dhe juridikë vendas	0
1.2.2	Mjete monetare të krijuara nga aktiviteti i subjektit zgjedhor	0
1.2.2.1	Fonde të krijuara nga kartat e anëtarësisë dhe kontributet e anëtarëve	0
1.2.2.2	Fonde të krijuara nga marrëveshjet me palët e treta	0
1.3	Donacionet e përfituara në sende dhe shërbime të vlerësuara me vlerë tregu	0
1.4	Përfitime nga reklama televizive sipas nenit 84 pika 6	0
1.5	Të tjera	0
Shuma totale e fondeve		4,794,329

Në pasqyrën e të ardhurave paraqitet si zë më vete dhe shuma prej 577,000 lekë si "të ardhura nga burime të tjera", e cila pasqyron rimbursimin e Partisë BDNJ për konsumin e energjisë nga një subjekt tjetër.

PBDNJ ka qenë përfitues i fondeve publike të arkëtuara në llogarinë bankare Alpha Bank Lek me numër Iban AL92902112090201250000440062 si më poshtë:

Institucioni	Shkresa	Datë	Vlera LEK	Data arkëtimit
Ministria Financave, DPB	Nr.1754/2 Prot	20/02/2014	1.598.109	11/03/2014
Ministria Financave, DPB	Nr.1754/2 Prot	20/02/2014	532.703	15/04/2014
Ministria Financave, DPB	Nr.1754/2 Prot	20/02/2014	532.703	03/09/2014
Ministria Financave, DPB	Nr.1754/2 Prot	20/02/2014	532.703	11/09/2014
Ministria Financave, DPB	Nr.1754/2 Prot	20/02/2014	1.598.111	14/10/2014

Bazuar ne shkresën Nr. 1754/1 Prot, datë 18/02/2014 të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Monitorimit dhe zbatimit të Buxhetit, "Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike" për Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut buxheti vjetor për vitin



2014 është në shumën 6.392.441 lek. Nga kjo shumë 4.794.329 lekë janë arkëtuar në llogarinë bankare të Partisë, si përshkruhet në tabelën e mësipërme. Pjesa e paarkëtuar nga buxheti vjetor 2014, në shumën 1.598.112 lekë (1.065.408+532.704 lekë), është rezultat i zbritjes së fondeve për partitë politike në zbatim të shkresës 15178 Prot, datë 04/11/2014.

PBDNJ nuk ka qenë përfitues i asnjë fondi për qëllime të fushatës zgjedhore nga persona fizikë apo juridikë vendas.

III.2 SHPENZIMET E KRYERA PËR VITIN KALENDARIK 2014

Pershkrimi sipas natyres		Vlera
Nr.	Natyra e shpenzimeve	
2	Shpenzimet e kryera	
2.1	Paga e Shpërblime për fushatën zgjedhore	1,972,220
2.2	Qera salle	138,320
2.3	Shpenzime telefonike dhe internet	288,232
2.4	Shpenzime energji ujë	350,866
2.5	Shpenzime udhëtime dieta	378,200
2.6	Taksa vendore	28,936
2.7	Komisione bankare	9,186
2.8	Të tjera	2,433,903
Shuma totale e shpenzimeve		5,599,862.8

Shpenzimet e kryera janë bazuar në fatura të rregullta tvsh-je, fatura të thjeshta tatimore, kupona tatimore, mandat pagesa dhe urdhra të brendshëm ekzekutivë.

III.3 PASQYRA E MJETEVE MONETARE

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ka vepruar nëpërmjet llogarisë bankare në Tirana Bank lek me numër Iban AL43206110040000100302504100.

Lëvizjet në arkë dhe bankë rezultojnë si më poshtë:

	<i>Në fillim të periudhes 01/01/2014</i>	<i>Hyrje 2014</i>	<i>Dalje 2014</i>	<i>Në fund të periudhes 31/12/2014</i>
	<i>Lek</i>	<i>Lek</i>	<i>Lek</i>	<i>Lek</i>
Depozita në arke	257,963.00	3,677,000.00	3,555,928.00	379,035.00
Depozita në bankë	1,665,595.34	4,794,329.00	5,143,934.76	1,315,989.58
Totali	1,923,558.34	3,677,000.00	3,555,928.00	1,695,024.58

EFTALI QIRJAQI



*Adresa: Lagje "Qemal Stafa", Rr. Studenti",
Shkodër, Albania*

Cel. 06902079434, Cel 0692069434

e-mail: eliqirjaqi@yahoo.com

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Shkodër, me 26/10/2015

Eftali QIRJAQI